KOMUNIKATË PËR MEDIA

Konferenca përmbyllëse e fazës së dytë të Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

27 maj 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt Konferenca përmbyllëse e fazës së dytë të Regjistrimit të popullsisë, pra të grumbullimit të të dhënave në terren që nga fillimi i Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) në terren më 04 prill 2024.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, ka deklaruar se për këtë fazë, faza e grumbullimit të të dhënave në terren për Regjistrimin e Popullsisë, ka përfunduar më 24 maj.

Tutje, z. Kastrati ka falënderuar të gjithë qytetarët, institucionet qeveritare, grupin punues për të dhënat dhe sigurimin e të dhënave. Një falënderim i veçantë është dhënë për komunat dhe përfshirjen e tyre. Janë falënderuar sidomos regjistruesit dhe mbikëqyrësit në terren. Aq më shumë është falënderuar personeli i ASK-së, vullneti, angazhimi dhe përfshirja e të cilëve ka qenë e pashembullt.

Gjithashtu me respekt të veçantë janë falënderuar edhe komunat dhe partitë politike, pa dallim. Me punën e palodhshme të personelit të ASK-së, procesi ka arritur të shmangë shpenzimet prej më se dy milion eurove në krahasim me shtetet e rajonit.

Z. Kastrati tha se është tejet me rëndësi që të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) sipas rezultateve të monitorimit ndërkombëtar janë të pranueshme dhe me këtë të krahasueshme globalisht edhe në Evropë.

ASK-ja do t'i publikojë të dhënat preliminare, që sipas standardeve do të përmbajnë vetëm disa indikatorë, në muajin korrik, e që është afat rekord i këtij procesi. Ndërsa të dhënat përfundimtare do të publikohen pas gjashtë muajve.